



08 /Nr. 6841 /2020
Data: 23.09.2020

PROCESVERBAL I DEBATI PUBLIK

Mbajtur me datë 18.09.2020 në Sallën e Takimeve të Komunës së Hanit të Elezit. Ashtu siç ishte paralajmëruar nëpërmes informimit debati publik filloi në ora 14:00 prezent ishin 27 qytetarë të Komunës së Hanit të Elezit. Prezent në debat ishte Kryetari i Komunës z.Rufki Suma.

Takimin e kryesoj Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik znj. Sevime Laçi

1. Shqyrtimi i propozim rregullores për fillimin dhe mbarimin e orarit të punës të subjekteve afariste në territorin e komunës së Hanit të Elezit.

Sevime Laçi fillimisht ju falënderoi për kohë që keni ndahu pre me marr pjesë në këtë debat publik. Drejtorja është e obliguar që para se ta procedon për miratim këtë rregullore ti dëgjion shqetësimet dhe propozimet e qytetarëve dhe të bizneseve. Rregullorja është hartuar nga komisioni për hartimin e akteve. Para se të procedojmë më tutje kërkoj nga kryetari i komunës që të ju përshëndes dhe të diskutonë sa i përketë kësaj rregullore.

Rufki Suma është obligim ligjorë që pas shqyrtimit në KPF dhe në Kuvendin e Komunës rregullorja të shqyrtohet edhe në debat publik dhe pastaj të procedohet në kuvendin e komunës. Andaj ju si biznese mund të jepni propozimet e juaja. Propozimet të cilat ipen në këtë debat publik do të përcillet në Kuvendin e Komunës.

Veton Zeqiri sa i përket kujdestarive 24 është shumë e vështirë për barnatoret për shkak se rastet pas orës 24 trajtohen në urgjencë dhe nuk kanë nevojë për barnatore. Propozoj që mos të jetë në këtë formë. Dita e diell është mirë të jetë pushim.

Besiane Bushi propozoj që dita e diell dhe ditët e festave që janë për sektorin publikë të jetë festë zyrtare edhe për sektorin privat. Do të ishte mirë që drejtorja për shëndetësi ta përcakton orarin dhe Barnatorja e cila është hapur pas orës 24 ta ketë dritën dhezuar dhe plusin në mënyrë që të funksionon si barnatore e hapur ta ketë numrin e telefonit. Barnatorja e cila e ka atë ditë kujdestari duhet të ketë parasysh që barnatoret tjera mos me qenë të hapura.

Afrim Shkreta propozoj që dita e diell të jetë pushim.

Nexhemdin Kuka propozoj që për gastronomi dita e diel të jetë pushim.

Sevime Laçi a ka edhe ndonjë diskutim për këtë pikë të rendit të punës, nëse nuk ka ju faleminderit për pjesëmarrje.

Debati përfundoi në ora 14:40 .

Procesmbajtësi
Avni Bushi



Drejtoresha për Zhvillim Ekonomik
Sevime Laçi

